



Relacioni Shkollë-Familje

Së bashku për të mirën e fëmijëve

Familja me shkollën ndajnë misionin e tyre thelbësor në arsimin dhe edukimin e të rinjëve. Partëneriteti ose bashkëpunimi duhen të mishërohen sipas principeve themelore të njohura dhe të respektuara nga të gjithë. Institucioni shkollë udhëhiqet (drejtohet) sipas ligjeve «shkollore» të vitit 1962, i cili rrjedhë nga teksti i ligjëvendësve. Ajo është e mbikëqyrur nga kantoni por komunat gëzojnë një autonomi të gjerë. Mësimdhënësit gëzojnë gjithashtu një autonomi të gjerë në mënyrën e



dhënies së mësimin. Të tentojmë të cekim të drejtat dhe detyrat e secilit të cilat duken si të ndërlikuara, Federata romande e Shoqatave të prindërve të nxënësve të Vales (FRAPEV) ka marrë iniciativën të mbledhë një numër të caktuar vendimesh të cilat i ka nxjerrë në dritë. Komisioni pedagogjik i shoqatës pedagogjike të Vales (SPVal) e ka përmbajt këtë iniciativë duke ja sjellë sensibilitetin e mësuesit. Më në fund departamenti i Arsimit kulturës dhe sportit (DECS) e vërtetoi këtë dhe e mori përsipër ti dorëzoi prindërve nëpërmes shkollës.

Dispozitat të cilat i përmban kjo broshurë nuk i zëvendëson tekstet që janë në fuqi.

Ajo i drejtohet dhe cakton kornizën e

përgjithshme në të cilën janë të shkruara relacionet në mes familjes e institucion shkollë. Autoritet shkollore dhe mësimdhënësit janë të të njëjtit mendim që ta bëjnë informimin sa ma kompletë atyre prindërve të cilët kanë nevojë.

Me ndihmën e shërbimit shtetëror dhe atij civil për të huajt, i cili ka përsipër integrimin e të huajve, edicioni 2007 është përkthyer për herë të parë në gjuhët e komuniteteve ma të rëndësishme të cilët jetojnë në kantonin tonë (italisht, portugalisht, shqip, serbo-kroatisht dhe anglisht)

Një njohje e gjuhës së regjionit mikpritës është kusht i domosdoshëm për prindërit e të huajve (babai dhe nëna) që të jen në gjendje ta kuptojnë më mirë funksionimin e institucioneve e në veçanti atë të shkollës. Ashtu, ju mundeni më mirë të mbështesni fëmijën tuaj gjatë shkollimit e më vonë në zgjedhjen e një profesioni ose vazhdimin e shkollimit profesionale.

Ne insistojmë veçmas në rëndësinë e madhe që ja përkushton shteti ynë barazisë në mes vajzave dhe djemve që është e nevojshme për fëmijën, që të dy prindërit të jen aktiv në lehtësimin e marrëdhënjeve familje-shkollë

Mundi i bërë për të mësuar gjuhën e vendit mikpritës mundëson pa kurnjëfarë dyshimi një mardhanje ma të mirë në mes prindërve të shpërngulur dhe shkollës, po ashtu në përgjithësi në mes të shpërngulurve dhe shoqërisë ose vendit mikpritës.

Përgjegjësia e prindërve

Në veçanti sipas:

Ligjit mbi arsimin publik i 4 korrikut të 1962 dhe të Kodit Civil Zviceran

Shkolla vlezane ka misionin e saj të përgjithshëm të ndihmoj familjen në edukimin dhe arsimimin e të rinjve.

- ◆ Edukimi i fëmijët në radhë të parë është punë e prindërve.
- ◆ Ata në veçanti marrin për sipër përgjegjësin për prezencën e fëmijve të tyre në shkollë: ata duhet të interesohen për sjelljet e tija në punë, përgjigjet për gabimet e tija që mundë ti sjellë.
- ◆ Babai ose nëna të cilët nuk kanë mbikëqyrjen prindërore mbi fëmijën ata do të jen të informuar për ngjarje të veçanta që ndërhyjnë në jetën e fëmijve dhe do të bisedohet me ata para se të merren vendimet e rëndësishme për zhvillimin e tij. Ju mund të njoftoheni te ata të cilët e marrin përsipër fëmijën tuaj për gjendjen dhe zhvillimin e tij.
- ◆ Vijimi i parashkollorës nuk është i obliguar. Por në ndërkohë prindërit angazhohen ti respektojnë dispozitat që janë në fuqi, në lidhje me vijimin e rregullt të mësimin.



Lirimi –pushimi -mungesat

Sipas, veçanërisht :

Rregullat në lidhje me masat disiplinore të aplikuara në kuadër të shkollimit të obliguar

- ◆ Vijimi i të gjitha mësimëve i paraparë me plan-program është i obliguar. Me kërkesën e prindërve ose të mbikëqyrësit, nxënësi mundë të lirohet nga orët e mësimin t fesë (religjionit).
- ◆ Për planifikimin e pushimeve, i lusim prindërit që të respektojnë plan-programin shkollor pikë për pikë.
- ◆ Prindërit janë përgjegjës për mungesë të lejuar, që është kërkuar nga ata, por edhe për vazhdimësinë e plan-programit shkollorë nëse fëmija i tyre mungon.
- ◆ Prindërit nuk duhet të keqpërdorin kërkesat për pushim.
- ◆ Inspektori shkollor ka të drejtë të dënojë prindërit të cilët len mas dore shkollimin e fëmijve, atyre të cilët bëjnë kërkesa për pushim, nëse ata shërbehen me deklarata të rrejshme, dënimet mund të jen nga 400 deri në 1000 franga.

Sigurimi shëndetësor i fëmijëve gjatë shkollimit

- ◆ Prindërit bëjnë sigurimin e fëmijëve të tyre kundër rrezikut të sëmundjeve dhe aksidenteve. Nuk ka sigurim të përbashkët shkollorë në rast të aksidentit prindërit i drejtohen drejtpërdrejt kompanisë së sigurimit ku ata e kanë bërë sigurimin.
- ◆ Legjislacioni për ndihma me të holla për shërimin e dhëmbëve parasheh këtë ndihmë: deri në 40% në mes komunës dhe kantonit, kurse 60% që mbesin merr për sipër prindi. Komunitat janë të lira të zgjedhin se a marrin pjesë në 60%. Shërimi duhet të bëhet si është i parapara në tërë kantonin e Vales.

Këshilla dhe informata :

- ☞ *Prindërit janë të detyruar të njoftojnë mësimdhënësin për problemet shëndetësore të fëmijve e cila ka rëndësi të madhe në marrjen e fëmijës përsipër.*
- ☞ *Prindërit duhet të marrin pjesë në takimet me mësimdhënësin (kujdestarin e klasës) të cilin drejtorja e shkollës e cakton.*
- ☞ *Prindërit njoftohen me informatat të cilat u a drejton shkolla dhe ato i vërteton me në nënshkrim se është njoftuar me ato.*
- ☞ ***Për materialet shkollore, kompet shkollore dhe aksionet tjera të caktuara, një pjesëmarrje financiare mundet ti lypet prindërve.***

Përgjegjësia e nxënësve

Sipas, veçanërisht :

Rregullat në lidhje me masat disiplinore në kuadër të shkollimit të detyrueshëm

- ◆ Nxënësit respektojnë rregullat dhe mirësjellen ; ata duhet të kenë veshmbathje adekuate dhe të pastërta.
- ◆ Duhet ti ruajnë të gjitha sendet të cilat i jepen në shërbim (lokalet,mobilitet, materiali) dëmtimi me qëllim ose pa qëllim është përgjegjësia e nxënësit.
- ◆ Në rast të mos nënshtrimit janë të parapara dënimet (qortimet, gjobat, vërejtjet prindërve...)
- ◆ Pirja e alkoolit, duhanit e drogave të ndryshme është e ndaluar.
- ◆ Shërbimi me telefon mobil është i ndaluar në klasë.

Informatë :

- ☞ *Për të favorizuar mirëfunksionimin e institucionit, komunitat mundë të vejnë në pah një marrëveshje për sjelljet ose rregullat e mbrendshme për shkollat. Këto i respektojnë rregullat e ndryshme që janë në fuqi.*

Përgjegjësia e mësimeve

Sipas, veçanarisht :

Ligji i 12 nëntorit 1982 i cili bën fjalë për trajtimin e personelit arsimor

Rregullorja e 20 qershorit 1963 në lidhje me kushtet e punësimit të personelit arsimor

Ata janë profesional, të formuar dhe në formim permanent. Në kuadër të mandatit të tyre ata angazhohen të ndihmojnë prindërit në edukimin dhe shkollimin e fëmijëve të tyre, duke i informuar ata për mbarëvajtjen shkollore të fëmijëve të tyre në të njëjtën kohë edhe sqarimin mbi qëllimet e tyre pedagogjike.



- ◆ Ata janë përgjegjës për disiplinën në klasë, ata bashkëpunojnë për mbarëvajtjen në shkollë po edhe nëse ka nevojë edhe në rrugë për në shkollë. Në rast nevojë mund të dënojnë me masat disiplinore të parapara me rregullore.

Takimi me prindërit

- ◆ Mësuesit i njoftojnë prindërit me qëllimet e tyre pedagogjike dhe progresin e fëmijëve të tyre në mbledhjet e përbashkëta ose individuale. Përndryshe ata i komunikojnë rregullisht rezultatet dhe zhvillimet e arritura për mes librezave.

Këshillë

- ☞ Sipas karakterit të takimit, pjesëmarrja e prindërit në takimet e përbashkëta ose individuale janë të rekomanduara ose më mirë të obliguara. Çdo herë ato bëhen me takim të caktuar me kërkesën e prindërit të cilit i përgjigjet mësuesi.

Qarkullimi i nxënësve gjatë orarit shkollor



- ◆ Zhvendosja gjatë orarit shkollorë bëhet në mbikëqyrjen të mësimeve.
- ◆ Për qarkullimin me biçikletë fëmija duhet të jetë në moshën e shkollimit të obliguar. Biçikleta duhet ti përshtatet madhësisë së fëmijës dhe duhet të jetë e pajisur me pajisjet e parapara dhe me vignette RC (pulle e përgjegjësisë civile për biçikleta).
- ◆ Në kuadër të aktiviteteve të veçanta mësimeve apo prindërit mund të transportojnë nxënësit me veturat e tyre private, por me kusht që nxënësit të jenë të siguruar kundër aksidenteve të qarkullimit, por me atë kusht që të respektohen rregullat e qarkullimit : mbajtja e nxënësve

sipas dispozitave të parapara, numri i nxënësve të mos tejkaloj numrin e autorizuar të lejuar në lejen e qarkullimit të automjetit...

- ◆ Është e mundur që komunat mund të shtojnë rregulla edhe më të ashpra.

Nxënësi me vështirësi

Sipas direktivave të Departamentit të Arsimit Kulturës dhe Sportit DECS

Pranimi i nxënësve me pengesa në shkollim është i organizuar sipas dispozitave që mundësojnë t'u ofrojnë masa të përshtatshme për çdo rast veçmas me :

◆ **Mbështetja e tërësishme pedagogjike**

Mbështetja e tërësishme pedagogjike është një masë me kohë të caktuar, që i drejtohet nxënësve që kanë nevojë për ndihmë të veçantë. Mësimdhënësi që punon me nxënësat që kanë nevojë për ndihmë të veçantë është në bashkëpunim të ngushtë me kujdestarin e klasës, me prindërit dhe me ndërhyrësit nga jashtë (inspektorin shkollorë, drejtorin dhe komisionin shkollorë). Bilanci i rregullt mundëson arritjet dhe progresin e arritur, i cili mundëson adaptimin dhe marrjen përsipër të fëmijëve të cilët kanë nevojë.

◆ **Plan-programi i përshtatur**

Për vënien në vend të një plan-programi të përshtatshëm duhet të jenë dakord prindërit dhe me leja e inspektorit shkollor. Formulari përcjellës duhet të përmbajë qartë objektivat e parapara deri në fund.

◆ **Mbështetja pedagogjike**

I drejtohet në veçanti atyre me gjuhë të huaja, në rrugën e integritit dhe atyre që hasin në pengesa gjatë shkollimit.

◆ **Përsëritja e vitit shkollor**

I bashkëngjitet raportit me saktësi ku precizohen masat e nevojshme për të kaluar vitin që fillon.

◆ **Strukturat tjera që marrin përsipër**

Shërbimi i mësimeve të specializuara është ai i cili i njofton prindërit për strukturat tjera të marrjes përsipër të fëmijëve me pengesa : klasë të veçantë, shkollë e AI-së e decentralizuar, institucione të specializuara...

Ndihma e parë për fëmijën në vështirësi vjen nga familja dhe mësimeve.

Mjeku i shkollës

- ◆ Një numër të caktuar të kontrollimeve dhe të vaksinimeve kryhen në kuadër të mjekësisë shkollore, sipas principeve në fillim të vitit shkollor, në klasën e 4 filleve dhe në klasën e 2 të ciklit të orientimit. Prindërit mundë të kundërshtojnë me një kërkesë me shkrim mjekimin ose vaksinimin.



Detyrat shtëpiake

Sipas udhëzimit të DECS-it



- ◆ Detyrat shtëpiake kanë për qëllim : pamëvarsimin e nxënësit duke e përforcuar atë çka e kanë mësuar në shkollë, po ashtu për të mbajtur kontakt dhe bashkëpunim me familjen.
- ◆ Ato duhet të ndryshojnë sipas moshës së nxënësit dhe duhet të realizohen në mënyrë autonome (vetanake). Kohëzgjatja mesatare sipas moshës së fëmijëve, në klasën e 1-re përafërsisht 10 minuta deri një orë në klasën e fundit të shkollës filleve. Sipas principeve nuk ka detyra gjatë vikendit dhe pushimeve shkollore. Këto norma janë sigurisht mënyrat e ndryshme të njërit apo tjetrit nxënës dhe të njërit apo tjetrit mësues.
- ◆ Roli i familjes vazhdon në krijimin e kushteve dhe mundësive që fëmija ti bëjë detyrat e shtëpisë, interesimi për aktivitetet e tija dhe njoftimin e mësuesit (kujdestarit të klasës) me pengesat e konstatuara, e gjithashtu me kohëzgjatjen e detyrave të shtëpisë.

Transferimi i nxënësve

Sipas direktivave të DECS

	Parashihen raste të ndryshme	Dokumentet që i përcillen (libreza shkollore, etj...)
a)	Nxënësi largohet nga një klasë për të shkuar në klasën tjetër në të njëjtin lokalitet apo komunë.	Të posa arriturve e bën kujdestari i klasës
b)	Nxënësi vijon shkollimin në shkollën e specializuar (St-Raphaël, St-Agnès, Notre-Dame de Lourdes, Don Bosco...).	Komisionit shkollor ose drejtorisë së shkollës në fjalë
c)	Nxënësi shkollohet në një komunë tjetër.	Komisionit shkollore apo drejtorisë së shkollës të vendbanimit të ri.
d)	Nxënësi largohet nga lokaliteti për të vijuar një shkollë publike të një kantoni tjetër.	Libreza shkollore i dorëzohet prindërve të nxënësit
e)	Nxënësi largohet nga Zvicëra.	Libreza shkollore i dorëzohet prindërve të nxënësit

Shpeshherë shkolla vetë e bënë transmetimin e dokumenteve të nevojshme. Është e rrugës që të siguroheni në rast se shpërnguleni (të pyesni se a janë transmetuar ato).

Procedura në rast mosmarrëveshje

Sipas ligjit të shërbimit publik

- ◆ Çdo pengesë relative në shkollë që vjen në mes nxënësve, prindërve, tutorëve (mbikëqyrësve) ose personave tjerë me personelin arsimor vendosë komisioni shkollore, me mundësi ankimi te inspektori shkollor.

Këshillë

- ➔ *Kontaktet e rregullta me mësimdhënësin shpeshherë mundësojnë largimin nga situatat e palakmueshme. .*

Kontaktet

Département de l'Education, de la Culture et du Sport (DECS)

Service de l'Enseignement, Planta 3, 1951 Sion

027/606.41.00

Fédération Romande des Associations de Parents d'Elèves du Valais Romand (FRAPEV)

Présidente : Claude Barras-Paris, ch. des Collines 12, 1950 Sion

027/322.76.69

Société pédagogique Valaisanne (SPVal)

Président : Didier Jacquier, ch. du Scex Carroz, 1904 Vernayaz

027/764.12.60

Ecole de

Commission scolaire/Direction :

Téléphone :

Enseignants :

Tél.

.....

Tél.

.....

Tél.